



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**  
**KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

# **Raporti Vjetor i Performancës**

**2008**

**Prishtinë, Prill 2009**

---

# **PËRMBAJTJA:**

## **PREZANTIMI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS.....	1
2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	3
3. TREGUESIT E REZULTATIT.....	5
4. BURIMET.....	8
5. DUKJA NGA JASHTË E ORGANIZATËS TONË.....	16
6. TË ARRITURAT STRATEGJIKE.....	17
7. PËRGJEGJËSIA E ZAP-SË.....	19

## **Aneks. Pasqyrat Financiare Vjetore të ZAP për vitin 2008**

---

# PREZANTIMI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Anëtar të Kuvendit

Dua të filloj duke ju falënderuar të gjithëve për gjithë përkrahjen e dhënë këtij institucioni gjatë viteve paraprake.

Tani keni në duart tuaja Raportin e parë të Performancës Vjetore nga Auditori i Përgjithshëm. Ky raport përqendrohet në atë se si Auditori i Përgjithshëm i ka shfrytëzuar burimet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2008. Gjithashtu, ky raport ofron edhe krahasimet me dy vitet paraprake fiskale. Detyrën e Auditorit të Përgjithshëm unë e kam pranuar rishtazi, më datën 1 mars 2008.

Raporti i Performancës Vjetore i ofron Kuvendit informata të rëndësishme kthyesë që mban të përgjegjshëm Auditorin e Përgjithshëm ndaj ekzekutimit të mandatit të tij gjatë vitit 2008. Në të njëjtën kohë, raporti shërben si një kontribut në dialogun në mes të Kuvendit dhe Auditorit Gjeneral për vitin buxhetor 2010.

Raporti mbulon një vit të rëndësishëm për Kosovën dhe për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Viti 2008 ka qenë viti kur është themeluar zyra si një institucion i vërtetë Kosovar, duke u bazuar në kushtetutën dhe në ligjin e ri për auditim të kësaj zyre. Menaxhimi i organizuar ndërkombëtarisht i zyrës përfundoi në Dhjetor dhe llogaridhënia në mes të Kuvendit dhe zyrës ishte sqaruar.

Një ndryshim kaq i madh i parakushteve krijon sfida për zyrën kur vjen puna te çështjet operative, si dhe administrative dhe financiare. Por, ai gjithashtu krijon kushte dhe mundësi të reja për zyrën dhe aksionarët kryesor të interesuar, të Legjislativit dhe Ekzekutivit. Këto marrëdhënie të punës do të zhvillohen edhe më tutje për të krijuar një kornizë të përbashkët referente për të gjithë ne.

Vizioni dhe strategjia jonë janë që të bëhemi një institucion publik i auditimit të jashtëm plotësisht në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën më të mirë Evropiane. Ky raport pasqyron se ne jemi në ditët e para të këtij rrugëtimi pa fund. Në të njëjtën kohë, ne jemi plotësisht të varur nga bashkëpunimi konstruktiv me aksionarët kryesorë për të përmbushur ambiciet tona të larta dhe qëllimin tonë reciprok - një sektor publik më të mirë dhe më të përgjegjshëm në Kosovë

Unë shpresoj se ky raport mund të kontribuoj në forcimin e këtij vizioni

Prishtinë 29 prill 2009



Lars Lage Olofsson  
Auditori i Përgjithshëm

---

## 1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

### Pikat kryesore

- Kemi raportuar për 54 auditime të kryera
- Auditimet tona kryesisht janë fokusuar në pajtueshmëri
- Kualiteti i auditimeve tona të kryera ka qenë ai i standardeve themelore
- Ne kemi audituar organizata që kanë mbuluar 71% të shpenzimeve totale dhe 86% të të hyrave totale;
- Edhe pse nuk janë respektuar afatet kohore, ne ishim në gjendje të auditojmë BKK-në me burimet tona vetanake dhe të raportojmë për këtë auditim më herët se kurrë njëherë
- Ne kemi iniciuar një numër masash për tu përballur me sfidat e reja që kanë të bëjnë me kornizën tonë të re ligjore;
- Një pjesë e madhe e kohës në punë është përkushtuar për zhvillimin e aktiviteteve nën projektet dhe trajnimet mbështetëse që aktualisht financohen nga KE
- Kemi filluar të përfitojmë në përvojat tona nga strategjitë e mëparshme zhvillimore dhe aktualisht jemi duke i marrur parasysh gjatë ndërtimit të kapaciteteve institucionale të Zyrës sonë në një mënyrë të qëndrueshme; dhe
- Të gjitha këto i kemi kryer në të njëjtën kohë- siç na është përcaktuar me mandatin tonë dhe pritjet tona- ekzekutimi i buxhetit në një nivel jo të mjaftueshëm.

### Fushat për përmirësim

Synime të veçanta të auditimit janë: Shfrytëzimi i drejtë dhe efektiv i fondeve publike; Zhvillimi i një menaxhimi të shëndoshë financiar; Ekzekutimi i drejtë i veprimeve administrative; dhe Kuntimi i informatave autoriteteve publike dhe publikut të gjerë nëpërmjet publikimit të raporteve objektive. Zbatimi i tërë kësaj konsiderohet si i domosdoshëm për stabilitetin dhe zhvillimin e shteteve në përputhje me qëllimet e Kombeve të Bashkuara (INTOSAI).

Synimi ynë është që të zhvillohemi në një Institucion Suprem të Auditimit (ISA) me Performancë të Mirë. Disa veçori të rëndësishme të kësaj do ti numërojmë në vijim:

- Përbushja e rolit tonë si një *shtyllë e rëndësishme e sistemit të llogaridhënies* në demokracinë moderne- një ndërgjegjësim i lartë konceptual i rolit dhe detyrave tona. Roli i një *verifikuesi të pavarur të informatave ekonomike dhe të performancës si dhe statusi nga këndvështrimi i ligjshmërisë dhe 3 E-ve (ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit)* në zinxhirin komandues: Kryeshef Ekzekutiv KE - Ministria - Qeveria dhe Kuvendi.
- *Raporte të mira pune* me Kuvendin dhe Qeverinë, Media dhe Publikun.
- *Veprim i baraspeshuar* me aktorët e tjerë në Sistemin e Menaxhimit të Financave Publike: duke optimizuar përfitimet në tërë sistemin e Menaxhimit të Financave Publike.
- Promovimi i standardeve të larta të transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit në menaxhimin financiar dhe performancën e administratës publike.
- Përbushja e plotë e *mandatit tonë të auditimit dhe fushëveprimit në mënyrë të baraspeshuar, qëndrueshme dhe afatgjate.*
- Duke ju përbajtur *standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht.*
- Të pranuar nga aksionarët tonë si një *burim i pavarur, objektiv dhe besueshëm i informatave.*
- *Dorëzimi i raporteve të auditimit të cilësisë së lartë dhe në kohë të duhur - duke ua shtuar vlerën palëve tona të interesuara.*
- Duke ofruar *procedura pasuese* të zhvilluara mirë në ndërmarrjen e veprimeve bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e auditimit për palët e interesuara – të audituarit, Qeveria dhe Kuvendi.
- Shfrytëzimin e qasjes moderne të Menaxhimit të Cilësisë së Plotë për *Menaxhimin Kualitativ të Auditimit.*

- 
- Një *organizatë me shikim nga jashtë* – duke kërkuar në vazhdimësi për përmirësime dhe për përdorimin më efikas të burimeve.

Transformimi i ZAP në një ISA me Performancë të mirë do të marrë kohë të konsiderueshme. Siç shihet nga rezultatet e arritura deri më sot, ne ende jemi në fillim të këtij procesi. Ne jemi në proces të themelimit të platformës së parë themelore për këtë shteg zhvillimor. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për shkathtësitë teknike. Këtu bëhet fjalë edhe për kuptimin e rolit të një ISA në një shoqëri demokratike dhe për strategjinë tonë afatgjate. Për më tepër këtu kemi të bëjmë me mënyrën e sjelljes kulturore në përputhje me vlerat tona: përgjegjshmëria, transparencja, sinqeriteti, reagimi dhe zhvillimi i ndryshimeve që duhet zbatuar në praktikë.

Ne duhet të ndërmarrim një hap të mençur për të implementuar një sërë platforma mjaft të fuqishme gjatë viteve në vijim. Do të krijojmë një platformë themelore në fund të këtij viti duke inkorporuar:

- RVP i parë i përpiluar të shërbej si bazë për përgjegjshmërinë si dhe një kontribut për një dialog më të zhvilluar për buxhetin me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit;
- Një kërkesë e buxhetit në përputhje me nevojat e paraqitura në këtë RVP dhe planet për periudhën e auditimit 2009/2010 si dhe vendosja e një forme të re të dialogut për buxhetin;
- Miratimi i plotësimeve në LMFPP për të siguruar një lidhje më të mirë në mes të auditimit të jashtëm dhe procesit të buxhetit;
- Një Raport Vjetor i Auditimit duke hapur rrugën për ndikimin më të mirë duke qenë në kohë të duhur dhe i një cilësie të mjaftueshme kur bëhet fjalë për analiza dhe lexueshmëri;
- Vëzhgimi i cilësisë themelore të raporteve të auditimit;
- Miratimi i një Plani Zhvillimor Strategjik që mbulon periudhën 2009-2014;
- Një strukturë e re organizative për të siguruar sigurinë e cilësisë së funksionimit tonë;
- Një doracak gjithëpërfshirës për rregullat e Auditimit;
- Udhëzuesin e parë për Auditimin e Performancës;
- Miratimi i kornizës për cilësinë;
- Miratimi i një politike për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm; dhe
- Miratimi i plotësimeve në rregullat e kodit të mirësjelljes.

---

## 2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

### **Kush jemi ne**

Unë jam emëruar në postin e Auditorit të Përgjithshëm në fillim të këtij viti nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në bazë të Zgjidhjes Gjithëpërfshirëse të Statusit nga ana e Qeverisë së Kosovës. E kam marrë detyrën më 1 Mars. Jam i detyruar të jem i pavarur nga Qeveria dhe ti raportoj drejtpërdrejt Kuvendit. Roli im është të ndërtojë kapacitetet organizative dhe të hapë rrugën për një Institucion Suprem të Auditimit të qëndrueshëm nën pronësi të Kosovës. Unë udhëheq një ekip që aktualisht disponon pothuajse 90 të punësuar si staf i auditimit dhe personel mbështetës.

Mandati dhe detyrat e mia janë të përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Është kritike ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë sonë nga organizatat të cilat i auditojmë. Pavarësia jonë duhet të sigurohet me zbatimin e mirë të një mandati të gjerë dhe të qëndrueshëm ligjor; në pajtueshmëri me standardet profesionale të auditimit; kodi të brendshëm të fortë të mirësjelljes profesionale; si dhe një mandat 5-vjeçar për Auditorin e Përgjithshëm.

### **Çfarë duhet të bëjmë?**

Në bazë vjetore do të kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, duke përfshirë këtu edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, gjithë Ministrinë dhe Agjencitë Ekzekutive, Komunat, Organet e Pavarura, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), dhe entitetet tjera që janë më shumë se 50% në pronësi publike ose pranojnë fonde publike, apo ato që sigurojnë dividendë ose të hyra tjera të patatueshme në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

Ne gjithashtu kemi fuqinë – por jo edhe obligim për të kryer Auditimin e Performancës aty ku mund të ekzaminojmë, ndaj kritereve të vendosura, nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar me kujdes të duhur, ekonomikisht dhe nën mënyrë efikase, dhe nëse janë të vendosura masat për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne do të raportojmë për auditimet tona tek entitetet dhe Kuvendi dhe këto raporte duhet të publikohen. Raportet tona do të përmbajnë rekomandime për të adresuar mangësitë më serioze të identifikuar.

Ne do të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, që karakterizohet me transparencë dhe përgjegjshmëri, duke siguruar se fondet publike raportohen administrohen dhe përdoren në mënyrë të duhur dhe me mençuri. Synimet tona janë tu ofrojmë siguri tatimpaguesve dhe donatorëve ndërkombëtarë se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase dhe ti shtojmë vlerë proceseve përkatëse zhvillimore.

### **Si do ta dëshmojmë përgjegjshmërinë?**

#### **Kush e auditon Auditorin e Përgjithshëm?**

Çdo vit, Kuvendi duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të audituar pasqyrat tona financiare të ZAP. Pasqyrat tona financiare do të përgatiten bazuar në LMFPP dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të Parasë së Gatshme.

Pasqyrat financiare për Vitin Fiskal 2008 janë të përfshira në këtë Raport Vjetor të Performancës. Këto pasqyra financiare nuk janë të audituara ende. Ne kemi caktuar Grant Thornton për të audituar pasqyrat tona financiare për vitin 2007 në Nëntorin e vitit të kaluar, dhe raporti i tyre ka përfunduar një muaj më

---

parë. Këtë dokument do t'ia bashkangjesim raportit tonë me qëllim të ofrimit të një pamjeje se si do të duket ai në të ardhmen. Propozojë që Kuvendi të emërojë një auditim për të dy vitet fiskale 2008 dhe 2009 para Shtatorit të vitit 2009 me synim që të mundësohet përpilimi i një RVP për vitin 2009 i bazuar në pasqyra të audituara financiare.

Sipas Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ne duhet të kemi në funksion një auditor të brendshëm për të audituar praktikën tona menaxhuese dhe ato të administrimit për të më siguruar mua se zyra është në pajtueshmëri me ligjet dhe politikën e vetë zyrës. Ky auditim i brendshëm do të ofronte menaxherëve, vlerësime dhe rekomandime. Ne ende nuk e kemi emëruar një Auditor të Brendshëm. Qëllimi ynë është që këtë ta bëjmë gjatë këtij viti.

### **Kush do të vlerësojë metodologjinë tona të auditimit?**

Puna jonë në auditim do të udhëhiqet nga kornizat rigoroze të metodologjisë dhe ato të menaxhimit kualitativ. Kornizat duhet të ofrojnë siguri të arsyeshme se auditimet tona janë kryer në përputhje me standardet e themeluara të praktikës profesionale.

Ne jemi në proces të vendosjes dhe testimit të këtyre kornizave dhe gjithashtu do të ri-organizojmë zyrën për tu siguruar që kornizat janë dizajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe se veprojnë në mënyrë të efektive.

Në një perspektivë afatgjate ne po shqyrtojmë vendosjen e rishikimeve të jashtme periodike nga partnerët tanë, sikur në Institucionet tjera Supreme të Auditimit.

### **Kush do të rishikoj financimin tonë?**

Si një Auditor i Përgjithshëm, unë duhet që të – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës, fokusohem në atë se si është shpenzuar buxheti i Zyrës – dhe në baza vjetore të përgatis dhe dorëzojë Kuvendit kërkesa për buxhet. Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më ftojë mua për të shpjeguar kërkesën për buxhetin e zyrës dhe do të diskutojmë raportin tonë lidhur me planet dhe prioritetet, qëllimet e performancës, Raportin tonë Vjetor të Përfundimit, dhe praktikën tona menaxheriale.

Buxheti i zyrës do të miratohet nga Kuvendi, dhe Qeveria do të inkorporojë buxhetin e akorduar midis Komisionit për Buxhet dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në draft buxhetin e BKK-së.

### **Korniza jonë strategjike**

Strategjia jonë afatgjate synon të kontribuojë në menaxhimin më të mirë të programeve të Qeverisë dhe llogaridhënien më të mirë para Kuvendit. Ne duam të bëjmë ndryshime dhe rezultatet tona do të jenë të lidhura me atë që ne bëjmë (kryerjen e auditimit), atë çfarë ne dorëzojmë (auditimet, pikëpamjet, rekomandimet, informatat dhe këshillat) dhe cilësia me të cilën ne e bëjmë këtë.

Korniza jonë strategjike përfshinë Planin tonë Strategjik të Zhvillimit, Doracakun e Auditimit të Rregullsisë, Udhëzuesin e Auditimit të Performancës, Kornizën e Menaxhimit Kualitativ, dhe Kodin e Mirësjelljes: të cilat janë në proces të rishikimit me qëllim të vendosjes së një platforme të re në zyrë, gjatë Gushtit të këtij viti.

### 3. TREGUESIT E REZULTATIT

Treguesit e rezultatit që ne i përdorim këtë vit, janë:

- Numri i raporteve të përpiluara;
- Mbulimi i auditimit (ato vetanake dhe / ose të kontraktuesve tanë);
- Afatet e raporteve tona;
- Kualitetin; dhe
- Ndikimi.

Gjatë vitit 2008 ne kemi realizuar dhe raportuar 35 auditime të rregullsisë me burimet tona vetanake dhe kemi kontraktuar 19 auditime. Gjithsej këto 54 auditime kanë mbuluar organizatat që kanë përfaqësuar 71% të totalit të shpenzimeve dhe 86% të totalit të të hyrave të BKK.

Tabela 1, tregon në mënyrë të qartë një rënie të auditimeve të kryera me burime vetanake gjatë vitit 2008. Kjo pjesërisht mund të shpjegohet me faktin se gjatë këtij viti ka pësuar një grevë e Auditorëve që zgjati 7 javë, .

Së dyti mund të vërehet se edhe mbulimi i auditimeve - bazuar në numrin e organizatave - gjithashtu është zvogëluar. Duke ditur se ne i kemi destinuar €260,000 për kontraktime të auditimeve të jashtme në buxhetin tonë (shih tabelën 2) mund të prisnim një mbulim më të mirë. Kjo nuk është bërë dhe si pasojë buxheti ynë për vitin 2009 u zvogëluar dhe kështu ka reflektuar nën ekzekutimin aktual të buxhetit në vitin 2008.

**Tabela 1. Raportet e publikuara të Auditimit<sup>1</sup>**

Të Audituarit	2008			2007			2006		
	Auditimet e Detyrueshme	Të audituar		Auditimet e Detyrueshme	Të audituar		Auditimet e Detyrueshme	Të audituar	
		ZAP	Kontraktues të jashtëm		ZAP	Kontraktues të jashtëm		ZAP	Kontraktues të jashtëm
BKK	1	1		1	1		1	1	
Autoritet Publike Shtetërore	23	16		19	17		19	13	1
Komunat	33	10	19	31	27		30		30
BQK	1			1			1		
Të tjera <sup>2</sup>	51	8		50	8	1	43	7	
<b>Gjithsej</b>	<b>109</b>	<b>35</b>	<b>19</b>	<b>102</b>	<b>53</b>	<b>1</b>	<b>94</b>	<b>21</b>	<b>31</b>

□

<sup>1</sup> Shënimet e paraqitura për vitin 2008 mbulojnë auditimin e vitit fiskal 2007, shënimet e paraqitura për vitin 2007 mbulojnë auditimin e vitit fiskal 2006 dhe kështu me radhë.

<sup>2</sup> Kategoria të tjerë përfshinë Kryeministrinë, AKM, Doganat, SHPK-në Zyrën Ndërlidhë të TMK-së, Ndërrmarjet Publike dhe disa agjenci tjera me buxhet më të vogël



Tabela 2 tregon se cilat auditime janë kryer nga kontraktues të jashtëm dhe po ashtu tregon koston e tyre. Vlen të përmendet se auditimi i pasqyrave financiare të ZAP për vitin 2007 është kontraktuar.

**Tabela 2 Auditimet e kryera nga kontraktues të jashtëm**

AUDITIMET	2008	PËRSHKRIMI	2007	PËRSHKRIMI	2006	PËRSHKRIMI
Zyra e Presidentit						
Kuvendi					€29,963	Deloitte&Touche
Ministritë						
Komunat	€54,480	19 Komuna Deloitte&Touche			€74,600	30 Komuna Audit&Conto
BKK					€46,345	Netherland Court of Audit
AKM			€39,675	Grant Thornton		
ZAP	€6,000	Grant Thornton				
<b>Gjithsej:</b>	<b>€60,480</b>		<b>€39,675</b>		<b>€150,909</b>	

Asnjë nga opinionet e dhëna gjatë vitit 2008 - si edhe viteve paraprake – kanë përfunduar si “jo të kualifikuara”. Jemi duke dhënë opinion të pa kualifikuar atëherë kur ne - në të gjitha aspektet materiale - jemi të kënaqur që:

- (a) pasqyrat Financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika që janë aplikuar në mënyrë konsistente;
- (b) pasqyrat janë në pajtueshmëri me kërkesat statusore dhe rregulloret përkatëse;
- (c) pikëpamja e prezantuar nga pasqyrat financiare është konsistente me njohuritë e Auditorit të entitetit të audituar; dhe
- (d) ekziston një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale lidhur me pasqyrat financiare.

Opinionin jonë i kualifikuar paraqet probleme të rënda në raportimin financiar, si dhe në menaxhimin financiar të buxhetit publik.

Auditimet e kryera kanë qenë të standardit themelor, të fokusuar drejt përputhshmërisë së transaksioneve individuale<sup>3</sup>. Kjo shpie në një numër të madh të rekomandimeve që kanë vlerë të vogël individuale. Duke mos i adresuar shkaqet sistematike të problemeve ne nuk ndihmojmë në marrjen e masave preventive që do të zvogëlonin rreziqet në sistemet aktuale në mënyrë të organizuar.

Për këtë, numri i rekomandimeve të dhëna ishte i lartë, mesatarisht rreth 500 në vit përgjatë tre viteve të fundit. Një shqetësim për ne është se të audituarit e bëjnë zbatimin e rekomandimeve tona në një shkallë shumë të ulët, rreth 35%. Kjo do të thotë se ndikimi ynë nuk është i mjaftueshëm, dhe për këtë problemet e njëjta përsëriten përgjatë viteve. Ne duhet të analizojmë më tutje arsyen për këtë situatë dhe të gjejmë qasje praktike për të tejkaluar këto sfida. Kjo do të bëhet gjatë vitit 2009 dhe do të merren masa për të përmirësuar këtë situatë më mirë në të ardhmen. Një tjetër aspekt i kësaj është edhe interesimi i kufizuar nga ana e Kuvendit për të ndërmarrë veprime për ndonjë raport që nuk përshtatet në kornizën kohore të procesit të buxhetit dhe në të njëjtën kohë rëndësia e këtij niveli të zinxhirit të përgjegjësisë mund të diskutohet.

□

<sup>3</sup> Shiko Vlerësimin lidhur me Auditimin e Jashtëm të kryer nga SIGMA, Maj 2008

---

Një sfidë e madhe për ne është të korrigjimi i proceseve tona, që ne të përfundojmë auditimet tona me kohë. Gjatë vitit 2008, vetëm 10 auditime janë publikuar me kohë, megjithatë raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të BKK është dorëzuar më herët se kurrë më parë.

Kjo mungesë e respektimit të afateve kohore dhe ndërlidhja e kufizuar në raport me procesin e llogaridhënies e ul vlerën e auditimeve të kryera. Këtë e bënë edhe lexueshmëria e dobët e raporteve tona. Ka vend për forcimin e përpjekjeve tona me qëllim të lehtësimit të një raportimi më të mirë financiar dhe menaxhimit financiar.

Aktualisht, ne po ndërmarrim masa për të ndryshuar këtë situatë dhe qasjet tona për raportimin e auditimit e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2008.

Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet se kemi ndërmarrë hapat e parë për të prezantuar auditimet e performancës për vitin 2008. Kjo do të jetë një pjesë e rëndësishme e portofolit tonë veprues në të ardhmen.

#### 4. BURIMET

Sikurse në vitet e kaluara, burimet janë degëzuar nga tri burime të ndryshme: nga buxheti i BKK, Shtylla IV e UNMIK-ut (zëvendësuar me financim të ICO nga mesi i vitit 2008) dhe AER-it. Këto kontribute janë të detajizuara më poshtë.

##### Buxheti i BKK

Për vitin 2008 buxheti ynë nga BKK-ja ishte € 1.204,239. Nga kjo shumë ne kemi përdorur € 862.630 apo 71,6%. Kjo shkallë e zbatimit të buxhetit është dukshëm më e ulët, posaçërisht duke iu referuar faktit se ne nuk kemi mbuluar mandatin tonë në mënyrë të kënaqshme, dhe në të njëjtën kohë ne kemi pasur burime prej € 260,000 të destinuara për auditime të jashtme, nga të cilat kemi shpenzuar vetëm € 60,000 (shih tabelën 2). Si rezultat i ekzekutimit të dobët të buxhetit, buxheti na është reduktuar rëndë për vitin financiar 2009 dhe buxheti ynë i përgjithshëm ka rënë në € 1,106.963.

Tabela 3. Buxheti (BKK)

Raporti i Buxhetit	Buxheti Primar	Buxheti Ndryshuar	Buxheti Shpenzuar	%
<b>2006</b>				
<b>Buxheti Total 2006</b>	1,177,523	1,177,523	953,420	81.0%
<b>Pagat dhe mëditjet</b>	332,161	332,161	318,347	95.8%
<b>Mallrat dhe Shërbimet</b>	817,362	817,362	613,659	75.1%
<b>Komunalit</b>	28,000	28,000	21,414	76.5%
<b>Shpenzimet Kapitale</b>	-	-	-	-
<b>2007</b>				
<b>Buxheti Total 2007</b>	1,242,658	1,226,798 <sup>4</sup>	852,979	69.5%
<b>Pagat dhe mëditjet</b>	358,115	347,295	335,757	96.7%
<b>Mallrat dhe Shërbimet</b>	816,543	811,503	462,734	57.0%
<b>Komunalit</b>	28,000	28,000	22,593	80.7%
<b>Investimet Kapitale</b>	40,000	40,000	31,895	79.7%
<b>2008</b>				
<b>Buxheti Total 2008</b>	1,204,239	1,204,239	862,630	71.6%
<b>Pagat dhe mëditjet</b>	359,696	523,230 <sup>5</sup>	405,683	77.5%
<b>Mallrat dhe Shërbimet</b>	812,043	648,509	429,310	66.2%
<b>Komunalit</b>	32,500	32,500	27,637	85.0%

□

<sup>4</sup> I zvogëluar pas Rishikimit Gjashtëmuor të Buxhetit për vlerën € 15,860

<sup>5</sup> Gjatë Rishikimit Gjashtëmuor të Buxhetit, vlera prej € 163,534 është transferuar nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë pagat dhe mëditjet për ngritjen e pagave të auditorëve

Në krahasim me vitin 2007, pagat bruto gjatë vitit 2008 janë rritur për më shumë se 21%. Paga mesatare gjatë vitit 2007 ishte € 341 në muaj, dhe gjatë vitit 2008 është ngritur në € 423. Rritja ishte 24%. Rritja e pagave është bërë vetëm për stafin e auditorëve, dhe jo edhe për administratën.

#### Shtylla IV e UNMIK-ut / ICO

Shtylla IV e UNMIK-ut ka financuar 5 anëtarë të stafit për pjesën e parë të vitit 2008 dhe ICO (përkohësisht) ka vazhduar me financim pjesën e mbetur të vitit. Kjo është një zvogëlim i stafit krahasuar me një vit më parë. Ne nuk kemi shifrat e kostove sa i përket këtij stafi.

**Tabela 4 Stafit i ZAP i financuar nga Shtylla IV e UNMIK-ut**

KATEGORIA	2008	2007	2006
Auditori Gjeneral	1	1	1
Zëvendës Auditori Gjeneral (deri në fund të muajit Shtator 2008)	1	1	1
Këshilltar i Lartë Auditimit	1	1	1
Zyrtar Projektit	1	1	1
Asistent Auditimit	1	4	1
<b>Në Total</b>	<b>5</b>	<b>8</b>	<b>5</b>

#### Aktivitetet e financuara nga AER-i

Në vazhdim, AER ka financuar projektin, "mbështetje të mëtutjeshme për ZAP" gjatë vitit 2008. Ky projekt do të zgjat deri në fund të muajit Korrik të vitit 2009. Projekti është vazhdim i mbështetjes së mëparshme, siç tregohet në tabelën 5.

**Tabela 5 Projektet e financuara nga AER**

KATEGORIA	2008	2007	2006
Përkrahja e Krijimit dhe Themelimit të ISA në Kosovë	-	-	€ 1,100.314.89
Përkrahja e Auditimeve të ZAP	-	€ 400,000	-
Përkrahja e mëtutjeshme e ZAP-it	€ 960,000	-	-
<b>Në Total</b>	<b>€ 960,000</b>	<b>€ 400,000</b>	<b>€ 1,100.314.89</b>

Tabelat 3-5 tregojnë burimet që na janë dhënë në dispozicion në mënyra të ndryshme dhe me mekanizma të ndryshëm, kombinuar në total me € 2.100,000 plus 5 anëtarë të stafit me orar të plotë të punës.

Projekti i financuar nga ana e AER-it - në mes tjerash - këshilltarët që ishin të përfshirë në mënyrë domethënëse në aktivitetet operacionale - më shumë sesa në aktivitetet zhvillimore. Siç kuptohet nga tabela 6, kjo ka qenë një burim i rëndësishëm për ne, në një nivel më të lartë sesa në vitin paraprak.

**Tabela 6 Këshilltarët të cilët punojnë me orar të plotë të punës në kuadër të ZAP**

KATEGORIA	2008	2007 <sup>6</sup>	2006
Këshilltarë Afatgjatë për Auditim	1	3	3
Menaxher i Projektit	1		1
Asistent Administrativ	1	1	1
Përkthyes	4	4	3
<b>Në Total</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>8</b>

□

<sup>6</sup> 8 persona në mes të Shkurtit dhe Korrikut (300 ditë pune) në fakt barabartë me punën dyvjeqare të një personi

Duhet të kemi parasysh se stafi i financuar nga partnerët tonë janë konsideruar si ekspertë dhe ata kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur një rol thelbësor në menaxhimin e zyrës dhe në punën tonë në mënyra të ndryshme.

### Stafi vetanak

Tabela 7 tregon numrin aktual dhe kategoritë e ndryshme të stafit tonë të financuar nga ana e BKK. Ne kemi ndarë stafin tonë në staf kryesorë dhe mbështetës.

**Tabela 7 Kategoritë e personelit (me përfundim të vitit)**

KATEGORIA	2008	2007	2006
Auditori Gjeneral	-	-	-
<i>Stafi Kryesor</i>			
Zëvendës Auditori Gjeneral (prej muajit Tetor)	1	-	-
Drejtorët (Udhëheqësit e departamenteve)	8	8	8
Zëvendës Drejtorët	4	5	5
Auditorët e Lartë	9	9	14
Auditorët	18	13	11
Asistentët Teknikë të Auditimit	16	16	9
Auditorët në Trajnim	2	8	15
<b>Nën- totali</b>	<b>58</b>	<b>59</b>	<b>62</b>
<i>Stafi Përkrahës</i>			
Zyrtarët (Udhëheqësit e Njësive, Sektorët)	12	12	13
Përkthyesit	4	4	4
Shoferët	5	5	5
Stafi tjetër përkrahës	1	1	1
<b>Nën- totali</b>	<b>22</b>	<b>22</b>	<b>23</b>
<b>Totali</b>	<b>80</b>	<b>81</b>	<b>85</b>

Tabela 7 tregon në radhë të parë se organizata jonë ka pasur probleme në rekrutimin e stafit ashtu si janë rritur nevojat, dhe së dyti se numri i stafit përkrahës-sipas një krahasimi ndërkombëtar - është diç më i lartë. Deri në një shkallë, kjo mund të shpjegohet nga nevojat për përkthim / interpretim.

### Totali i burimeve të personelit për kryerjen e punës sonë

Nëse i shikojmë tabelat 4-7 të dyja së bashku tregojnë se zyra jonë ka 63 persona nga stafi kryesorë (duke përfshirë edhe Auditorin e Përgjithshëm) dhe 29 nga stafi përkrahës gjatë vitit 2008, të cilët janë në dispozicion për proceset e punës, shifra pak a shumë të njëjta sikur ato të dy viteve paraprake. Në vitin 2009, kemi diku rreth 8 persona më pak nga stafi i mëparshëm.

### Konkluzionet për burimet tona

Gjendja e resurseve tona është shumë shqetësuese. Ekziston një mangësi në mes të mandatit / pritjeve dhe resurseve që janë dhënë për të arritur këto pritje. Fakti që Stafi i Auditimit është shërbyes civil, e zvogëlon mundësinë tonë që të konkurrojmë në mënyrë të suksesshme në treg për auditorët dhe ti përdorim burimet të cilat posedojmë në mënyrë më fleksibile. .

Duke pasur parasysh faktin se për këtë vit – stafi i cili mbështetet nga BE-ja është zvogëluar në vetëm 2 (Auditori i Përgjithshëm dhe asistenti personal) burimet e stafit janë ulur ndjeshëm. Projekti i Binjakëzimit që fillon në Gusht të këtij viti do të zëvendësojë vetëm pjesërisht burimet aktuale të dhëna nga ana e projektit “Mbështetja e mëtutjeshme për ZAP” ( kalkuluar në fonde dhe ditët e punës).

Kjo është një sfidë për ne. Në kuadër të Planit Veprues të Implementimit të Partneritetit Evropian, ishte paraparë që stafi i auditimit i zyrës sonë duhet të rritet deri në 100% (20 % në vit) përgjatë një periudhe 5 vjeçare. Kjo duhet në mes tjerash të balancoj zvogëlimin e resurseve ndërkombëtare. Kjo skemë organizative nuk është prezantuar ende.

Për një kohë të shkurtër, do të jetë vendimtare për ne të kontraktojmë një përqindje më të madhe të auditimeve, në të njëjtën kohë si e përshtatim punën tonë në një cikël të auditimit i cili do të siguroj objektivat e strategjisë sonë.

### Kualifikimi Arsimor

Tabela 8 tregon kualifikimet arsimore të stafit tonë. Të gjithë auditorët tonë kanë kualifikim universitar.

**Tabela 8 Kualifikimi Arsimor**

KATEGORITË	2008	2007	2006
Ekonomist	56	57	60
Jurist	3	3	3
Edukim në Universitet tjera	8	7	8
Shkolla e mesme	13	14	14
<b>Në Total</b>	<b>80</b>	<b>82</b>	<b>85</b>

Vlen të theksohet se arsimimi në kontabilitet dhe auditim dhënë nga universitetet, përkundër progresit të viteve të fundit, nuk mund të krahasohet me standardet që aplikohen në fakultetet e ngjashme në shtetet brenda BE-së. Kjo situatë krijon shpenzime shtesë për organizatat- duke përfshirë Zyrën e Auditorit- të cilët punësojnë këta punëtorë në formë të trajnimeve themelore (bazike).

Do të jetë thelbësore për ne, së bashku me organizatat tjera që përballen me sfida të njëjta, të forcojmë bashkëpunimin tonë me fakultete dhe Qeverinë, në mënyrë që në të ardhmen të zvogëlojmë këtë problem.

### Trajnimet

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit dhe kohës sonë investohen në trajnime të vazhdueshme bazike për ti ndihmuar auditorët tanë që të arrijnë standardet themelore të profesionalizmit. Ofruesi i trajnimit është përgjithësisht Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), dhe skema e certifikimit përfshin tri nivele.

**Tabela 9 Niveli i provimeve të dhëna në SHKÇAK**

KATEGORITË	2008	2007	2006
<b>Auditorët e Licencuar</b>	18	25	33
<b>Kontabilist të Certifikuar</b>	18	13	12
<b>Kontabilist Teknik</b>	19	18	14
<b>Në Total</b>	<b>55</b>	<b>56</b>	<b>59</b>

Tabela 9 përfshin sfidat në ruajtjen e stafit tonë me eksperiencë më të gjatë si dhe atyre që kanë certifikime më të larta në organizatën tonë. Kjo është një situatë e natyrshme në tregun ekonomik, por në të njëjtën kohë ne duhet të mbajmë një qëndrim të fortë nëse duhet apo jo të veprojmë në formë të një qendre trajnuese për fushat tjera të ekonomisë dhe si pasojë e kësaj të bëjmë rekrutim të tepërt të stafit, apo do të përpiqemi që të sigurojmë mjete me të cilat do të jemi në gjendje të konkurrojmë në treg. Situata e tanishme na pengon në ofrimin e shërbimeve sipas standardeve tona dhe në shkallën më të lartë të efikasiteti.

Numri i ditëve që ne investojmë në trajnime bazike në SHKÇAK është i madh. Në Tabelën 10 ne kemi kalkuluar numrin e ditëve të trajnimit. Në vitin 2008, kjo tregon mesatarisht rreth 15 ditë për stafin tonë kryesor.

**Tabela 10 Ditët e trajnimit në SHKÇAK<sup>7</sup>**

KATEGORITË	2008	2007	2006
Auditorët e Licencuar	181	181	580
Kontabilistët e Certifikuar	543.8	145	688.8
Teknik i Kontabilitetit	75	50	250
<b>Në Total</b>	<b>799.8</b>	<b>376</b>	<b>1518.8</b>

Përveç kësaj, auditorët tanë marrin pjesë edhe në trajnime tjera profesionale që mbahen prej këshilltarëve aktual të jashtëm si dhe disa auditorë ndjekin trajnime shtesë jashtë organizatës.

Një masë tjetër është edhe programi trajnues CIPFA i Qeverisë për auditorët në sektorin publik. Ky program aktualisht ndiqet nga ana e 10 anëtarëve të stafit të ZAP.

Në tërësi, ne kemi vlerësuar se stafi jonë kryesorë është trajnuar mesatarisht 30 ditë në vit. Në total kjo do të thotë se nëse ne investojmë rreth 1800 ditë pune në vit prej diku rreth 13.800 ditë pune që kemi në dispozicion, do të thotë rreth 13%: gjë që paraqet një shifër të madhe nëse krahasohet me praktikat ndërkombëtare.

Këto trajnime kanë qenë ta pa strukturuara dhe organizuar. Nuk janë qartë të ndërlidhura me mandatin dhe detyrat e institucionit tonë si dhe nevojave tona afat shkurtra dhe afat gjata të trajnimeve që ne i kemi për të përmbushur misionin tonë. Kjo do të thotë që trajnimet nuk janë edhe plotësisht efikase si dhe rezultatet e tyre nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme.

Është e qartë se kjo është përgjegjësi e Auditorit të Përgjithshëm i cili duhet të gjej zgjidhje më efektive dhe të qëndrueshme për këtë çështje. Masat në këtë drejtim tashmë janë ndërmarrë.

Por, kjo është çështje e kulturës të të mësuarit në zyrën time. Trajnimi mund të ketë efekt maksimal vetëm atëherë kur zyra lulëzon nga kureshtja dhe gatishmëria për tu zhvilluar. Stimulimet për këtë, lënë vend për përmirësim.

#### ***Informata të shkurtra rreth stafit tonë***

Tabelat e mëposhtme japin informatë të rëndësishme dhe themelore rreth stafit në organizatën tonë. Shifrat tregojnë se ne jemi duke u përballur me sfida të rëndësishme sa i përket zhvillimit dhe mbajtjes së personelit të aftë dhe me përvojë të cilët janë në gjendje të absorbojnë dhe tu bëjnë ballë reformave në të cilat gjendemi.

□

<sup>7</sup> Ditët në trajnim janë kalkuluar sipas skemës së SHKÇAK që është: Niveli 1 – 145 orë për person; Niveli 2 – 145 orë për person, dhe Niveli 3 – 100 orë për person

**Tabela 11 Struktura e moshës**

KATEGORIA	25 - 40	41 - 55-	56 AND OVER
Auditori Gjeneral	-	-	
Zëvendës Auditori Gjeneral	-	1	-
Drejtorët (Udhëheqësit e Departamenteve)	2	6	-
Zëvendës Drejtorët	4	-	-
Auditorët e Lartë	6	2	1
Auditorët	10	8	-
Ndihmës Teknik i auditimit	13	2	1
Auditorët në trajnim	2	-	-
Zyrtarët (Udhëheqësit e Divizioneve, Sektorëve)	9	3	-
Asistentët	3	1	-
Shoferët	2	3	-
Stafi tjetër mbështetës	-	1	-

Tabela 11 tregon se rreth 2/3 e stafit të auditimit janë nën moshën 40 vjeçare dhe ne mund të fitojmë më shumë prej tyre gjatë viteve në vazhdim, nëse krijojmë ambient të punës interesant dhe stimulues për ta. Në të njëjtën kohë, një numër më i madh i drejtorëve (menaxherëve) tonë aktual i takojnë kategorisë më të vjetër. Për ne është me rëndësi të kemi një përzierje të mjaftueshme në nivel të menaxhmentit dhe ti japim anëtarëve më të ri të stafit mundësi më të mira për ngritje profesionale.

**Tabela 12 Lëvizja e Stafit**

KATEGORITË	2008	2007	2006
Stafi Kryesorë	8	5	7
Stafi mbështetës	2	7	6
Lëvizja e stafit në Total	<b>10</b>	<b>12</b>	<b>13</b>

Nga tabela 12 mund të shohim që lëvizja e stafit është duke u zvogëluar, përgjatë viteve. Siç është adresuar më parë, shqetësues është fakti që një numër i madh i auditorëve të licencuar e kanë lënë organizatën tonë. Rritja e pagave në Korrik të vitit 2008 mund të ketë pasur një ndikim pozitiv në këtë çështje.

Fakti se një numër i konsiderueshëm i auditorëve tonë të kualifikuar e kanë lënë organizatën tonë, natyrisht ka ndikuar në rezultatet tona. Fakti që jemi mbrapa zhvillimeve të pritura, mund të shpjegohet pjesërisht nga ky fakt.

**Tabela 13 Gjinia**

GJINIA	2008	2007	2006
Femrat	14	14	15
Meshkujt	66	67	70

Tabela 13 na tregon se numri i femrave në stafin tonë është jo-proporcionalisht më i ulët në zyrën tonë dhe ai nuk është zhvilluar gjatë viteve. Në qoftë se ne gjithashtu marrim parasysh se shumica e femrave mund të gjendet në pozicionet më të ulëta në organizatë, situata është më alarmante. Ne duhet të shqyrtojmë këtë situatë dhe të përpiqemi të ndërmarrim masa për të adresuar këtë. Një strukturë gjinore më e mirë do të na pasurojë.



**Tabela 14 Komunitetet**

KOMUNITETET	2008	2007	2006
Shqiptarë	76	77	80
Serb	3	3	4
Të tjerë	1	1	1

Tabela e mësipërme tregon se ne gjithashtu - kur është fjala për përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme - nuk kemi qenë të suksesshëm në përmbushjen e ambicieve publike në lidhje me mundësitë e barabarta. Përkundër ambicieve dhe masave të ndërmarra rezultati mbetet i dobët. Ne do ta analizojmë këtë situatë me qëllim që të bëhemi më të mirë.

Problemi kryesor për kolegët tanë Serb, janë mangësitë tona sa i përket sigurimit të trajnimeve të mjaftueshme në gjuhën Serbe. Janë ndërmarrë masa, por nuk është arritur ndonjë zgjidhje e qëndrueshme deri më tani. Parashikohen aktivitete të më tutjeshme sa i përket kësaj fushe.

Sa i përket gjinisë femërore, pozita e tyre në institucionin tonë është po ashtu shqetësuese.

### **Konkluzioni lidhur me gjendjen e Burimeve Njerëzore në Institucionin tonë**

Gjatë vitit financiar, ne kemi filluar me analizimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për situatën e përshkruar më lartë. Janë ndërmarrë masa për adresimin e tyre në një mënyrë të përqendruar dhe konsistente, që përbëhen nga:

- Forcimi i funksionit të BNJ;
- Prezantimi i mjeteve / veglave të reja të menaxhimit; dhe
- Një skemë certifikimi e cila në mënyrë të qartë lidhet me nevojat tona.

Në të njëjtën kohë, ne do të donim të drejtojmë vëmendjen tonë tek niveli i pagave tona, që ende mbetet një çështje brengosëse. Nuk duket si problematike për stafin relativisht të ri që të pranojnë oferta nga sektori privat apo edhe ai publik ku pagat janë dukshëm më të mira.

Tjetër çështje që ka ndikim në këtë situatë është ambienti i punës. Objekti i tanishëm i zyrës është - përveç që nuk ka vlerë të mirë - -nuk është i mjaftueshëm për nevojat tona të tanishme dhe të ardhshme.

Masa më të qarta duhet të ndërmerren në këtë fushë gjithashtu.

### **Informimi, Komunikimi dhe përkrahja Teknike (IKT)**

Një fushë e rëndësishme së madhe që ndërlidhet me suksesin tonë është edhe mbështetja e TI. Në parim, ne jemi – për shkak të ndihmesës nga partnerët tanë- të pajisur mirë kur bëhet fjalë për kompjuterë, laptop-a si dhe pajisjeve tjera ndihmëse teknike. Si rezultat i menaxhimit të pa zhvilluar të aseteve, ne ende po mbajmë një numër të konsiderueshëm të inventarit i cili nuk na nevojitet si dhe mbajmë pajisje që kanë dalë nga përdorimi. Janë ndërmarrë masa për zgjidhjen e kësaj situatë në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike.

Në vitin 2008 ne kemi dizajnuar faqen e re zyrtare të ZAP dhe kemi krijuar një harduer të ri për këtë.

Sfidat kryesore janë:

- Ne ende jemi - përkundër faktit që të gjitha investimet e nevojshme për tu ndarë nga rrjeti qeveritar, e që janë kryer përmes projekteve të mëhershme të përkrahjes – të lidhur në internet përmes Serverit të Qeverisë. Kjo krijon rrezik më të madh në lidhje me mbrojtjen e

---

informacioneve dhe kufizon shanset tona për të ndërmarrë masa të shpejta gjatë ndërprerjeve të shërbimeve;

- Ne ende nuk e përdorim softuerin të cilin e kemi me kapacitet të plotë; dhe
- Nuk përdorim në mënyrë efikase mbështetjen e IKT

Planifikojmë të zhvillojmë mbështetjen e IKT në mënyrë që të adresojmë këto pyetje, si dhe do të krijohet një qasje e re strategjike .

Ne do të zhvillojmë aftësitë tona që të përballemi me burime në dispozicion në mënyrë sa më të mirë. .

---

## 5. DUKJA NGA JASHTË E ORGANIZATËS TONË

Ne po përpiqemi për të bërë një organizatë përgjegjëse dhe një organizatë me imazh të mirë. Duke shikuar praktikën tona gjatë vitit 2008, mund të thuhet si në vijim:

### **Bashkëpunimi brenda Kosovës**

Në përgjithësi ne nuk kemi ndonjë problem të madh me bashkëpunimin tonë formal me partnerët tonë.

Bashkëpunimi ynë me Kuvendin ende duhet të zhvillohet dhe të forcohet. Ne jemi në një situatë të re pas aprovimit të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008 dhe të dy anët e këtij bashkëpunimi kanë nevojë për të gjetur mekanizmat e duhur për këtë. Ky raport shpresohet të jetë një mjet që mund të ndihmojë në këtë çështje, dhe unë e mirëpres mundësinë për të diskutuar në lidhje me këtë raport me Komisionin për Buxhet dhe Financa më vonë në këtë pranverë.

Bashkëpunimi jonë me autoritetet qeveritare, organizatave qeveritare, jo-qeveritare dhe organizatat e medias gjithashtu lënë hapësirë për përmirësim.

Bashkëpunimi i zhvilluar gjithmonë varet nga vlera e saj për palët e interesuara. Ne do të bëjmë çmos për të vendosur veten si meritore për besim dhe si partner të mirë, këshillat e të cilëve vlejné.

### **Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

Për shkak të faktit se Kosova nuk është njohur nga OKB-ja, Zyra jonë nuk ka të drejtë të bëhet anëtare e bashkësisë së Institucioneve Ndërkombëtare Supreme të Auditimit, një organizatë për bashkëpunim apo dega e saj evropiane (INTOSAI dhe EUROSAD). Anëtarësimet në këto organizata janë të rëndësishme për zhvillimin tonë, dhe ne kemi filluar marrjen e masave për të qenë më të ekspozuar ndaj trendeve dhe zhvillimeve ndërkombëtare, në krahasim me vitet e mëparshme.

Ne jemi anëtare të organizatës evropiane për auditimin e institucioneve regjionale (EURORAI) dhe gjatë vitit 2008 ne kemi marrë pjesë në disa nga takimet e organizuara prej tyre.

Në marrëdhëniet bilaterale, ne kemi hyrë në një marrëveshje bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë, dhe ne po ashtu kemi marrë pjesë në një ngjarje e cila është organizuar prej OSBE e që ka të bëjë me bashkëpunimin në mes të institucioneve të auditimit dhe Kuvendeve.

Përkundër faktit që bashkëpunimi ynë me partnerët tonë direkt të cilët kanë përvojë në praktikën evropiane më të mira në proceset tona zhvillimore ne nuk jemi zhvilluar mjaft me mekanizmat ku ne – vetvetiu - vazhdimisht jemi në kërkim për përmirësimin dhe efikasitetin kundrejt organizatave me sfida të ngjashme si tonat.

Kjo është një fushë që kërkon përmirësim.

---

## 6. TË ARRITURAT STRATEGJIKE

### Hyrje

ZAP-ja është në një fazë të transformimit. Misioni ynë është që të kontribuojmë në zhvillimin e menaxhimit të shëndoshë financiar në administratën shtetërore. Ne duhet të kryejmë auditime kualitative në bazë të praktikave më të mira Evropiane duke u përpjekur të ndërtojmë siguri në shpenzimin e fondeve publike. Me këtë ne kemi ndërmend të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe partnerëve të tjerë në shtimin e llogaridhënies publike.

Nën Ligjin e sapo-adaptuar mbi ZAP-në ne do të përpiqemi që të përmbushim mandatin tonë të auditimit bazuar në materialitet dhe rrezik.

Sipas Planit tonë të Zhvillimit Strategjik, që dy vite është në proces zhvillimi i vazhdueshëm duke na përgatitur neve për arritjen e rezultateve të parapara sipas ligjit të ri. Programi është fokusuar në:

- Sigurimin e kualitetit, pajtueshmërisë dhe ofrimin e shërbimeve profesionale; dhe
- Sigurimin e efikasitetit dhe rritjes së burimeve tona

Programi ynë i zhvillimit është - për shkak të pozitës sonë si një Institucion Suprem i Auditimit dhe për t'u bërë një anëtar i INTOSAI – e udhëzuar nga reformat e Menaxhimit të Financave Publike si dhe standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira.

### Treguesit mbi arritjet Strategjike 2008

Publiku dhe Kuvendi duhet të kenë besim se paratë e tyre janë përdorur me kujdes dhe në mënyrë të duhur në pajtim me ligjin dhe praktikën më të mira. Ne kemi rol qendror në këtë proces.

Sido që të jetë viti 2008 ka qenë një vit sfidues për ne, për shkak të predispozitave të reja ligjore, pritjeve të reja dhe faktit se Zyra nuk ka punuar për gati dy muaj.

Plani jonë i tanishëm i zhvillimit strategjik përmban katër shtylla:

- Kornizën e Re Ligjore
- Përgjegjësinë dhe Standardet Profesionale
- Ngritjen e Kapaciteteve Institucionale
- Shembullin e një Organizate Publike

1. Korniza e Re Ligjore: “Krijimi i kornizës së re Ligjore me qëllim që të zhvilloj një mandat të auditimit dhe proces të raportimit në përputhje me standardet ndërkombëtare.”

Gjatë vitit 2008 është aprovuar Ligji mbi themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës nga Kuvendi i Kosovës dhe është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Ligji është aprovuar pak si shumë me nxitim dhe ka lënë disa hapësira për përmirësim si dhe në të njëjtën kohë si konsistenca në mes të këtij ligji dhe ligjeve tjera me ndikim në biznesin tonë nuk është zhvilluar sa duhet. Pas implementimit të kornizës ligjore për një sezonë të auditimit (2009/10) qëllimi ynë është që të kthehemi tek Parlamenti me rekomandimet për përmirësimet ligjore të bazuara në përvojat e fituara në vjeshtë të vitit 2010.

2. Përgjegjësia dhe Standardet Profesionale: “Krijimi i një Institucioni Suprem të Auditimit të fortë, të pavarur dhe shumë-disiplinor që udhëhiqet nga shembujt që zhvillon dhe adapton standardet profesionale të përshtatshme dhe efektive”

---

3. Krijimi i Kapaciteteve Institucionale: “Të ndërtoj kapacitete të afta dhe profesionale brenda Zyrës së Auditorit Gjeneral përmes trajnimit, asistencës teknike dhe aktiviteteve tjera zhvillimore”

4. Shembull i një Organizate Publike: “Të organizoj dhe qeverisë Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm në mënyrë që të promovoj praktikat e punës më ekonomike, efikase dhe efektive; vendimmarrje kohore, dhe praktikat efektive qeverisëse”.

Zhvillimet përbrenda këtyre tri shtyllave ka qenë i kufizuar gjatë vitit 2008. Prapa kësaj qëndrojnë një numër arsyes. Ka të bëjë me mungesë të qasjes vjetore të strukturuar në intervenimet zhvillimore, mungesë të adaptimit organizativ, paqartësisë së objektivave dhe metodave dhe qasjet nuk janë zhvilluar plotësisht për forcimin e pronësisë dhe përgjegjësisë.

Konkluzionet prej kësaj tani janë përdorur në zhvillimin e një Plani të ri të Zhvillimit Strategjik dhe rregullimit të qasjeve për implementim të tyre.

---

## 7. PËRGJEGJËSIA E ZAP-së

Nëpërmjet kësaj ju siguroj se informata në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë këtu edhe Pasqyrat Financiare janë të sakta, të besueshme dhe objektive

Lars Lage Olofsson  
Auditor i Përgjithshëm



### Deklarata e Transparencës

Nëpërmjet kësaj ju siguroj se puna jonë gjatë vitit 2008 është zhvilluar në përputhje me Statusin e Shërbyesve Civil dhe Kodin e Mirësjelljes Profesionale të ZAP.


Qerkin Morina – Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Imer Vitia – Drejtor



Mujë Gashi – Drejtor



Kapllan Muhaxheri – Drejtor



Naser Arllati – U.d i Drejtorit



Ibrahim Gjylderen – U.d i Drejtorit



Imri Semetishti – Udhëheqës i Zyrës Ligjore



Mimoza Damoni – Udhëheqëse e TI; dhe



Fatmir Uka – Udhëheqës i Administratës



---

## **Opiniononi i jashtëm i Auditimit**

### **Hyrje**

Ky raport Vjetor i Performancës dhe pasqyrat financiare për vitin 2008 nuk janë audituar ende. Që t'ju japim një pamje se si do të duhej të duket në të ardhmen, ne kemi integruar Opinionin e Auditorit për vitin 2007, letrën e menaxhmentit për të njëjtin vit, dhe planet tona për ti adresuar çështjet që kanë tërhequr vëmendjen e Auditorëve tanë.

Kemi emëruar Auditorët për vitin 2007. Në pikëpamjen tonë, është praktikë e mirë që Kryetari - i Komisionit për Buxhet dhe Financa – i emëron Auditorët tonë. Ne propozojmë që Komisioni të emëroj Auditor për Auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2008 dhe për vitin 2009 brenda muajit që vjen me qëllim që këto raporte të finalizohen me kohë për të prezantuar një raport Vjetor të Auditimit të Performancës vitin e ardhshëm.

### **Opiniononi i Auditorit**

“Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të organizatës deri më 31 Dhjetor 2007, dhe të burimeve të saj, si dhe shfrytëzimit të fondeve për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, dhe se të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet e Organizatës përputhen me statutet dhe Rregullat që janë në fuqi”.

### **Draft Letra e menaxhmentit**

Ne kemi pranuar draft letrën e menaxhmentit para dy javëve.

Auditorët kanë “vërejtur disa çështje të caktuara që përfshijnë kontrollin e brendshëm dhe veprimet e tij, që konsiderohen të jenë mangësi domethënëse nën standardet e themeluara.

Çështjet që tërheqin vëmendjen e Auditorëve ndërlidhen me “dizajnimin ose veprimin e kontrollit të brendshëm, që sipas gjykimit tonë mund të ndikoj negativisht në aftësinë e organizatës që të regjistroj, procesoj, përmbledh dhe të raportoj të dhënat financiare në përputhjet me pohimet e menaxhmentit në pasqyrat financiare”.

- Asnjë faturë e duhur nuk është lëshuar nga pronari i ndërtesës sonë
- Pagesat nuk janë bërë sipas faturës relevante nga furnizuesi; dhe
- Mungesa e politikave dhe procedurave të detajuara dhe adekuate në lidhje me njohjen dhe shlyerjen e pasurisë, matjeve, koston së ardhshme dhe zhvlerësimit

Na është rekomanduar që të marrim masa që ta shtyjmë pronarin ti përmbahet Rregullave të tatimit dhe të forcojmë disa rregulla të brendshme me qëllim të zvogëlimit të rrezikut për veprime të gabueshme.

### **Plani jonë për të adresuar çështjet në letrën e Menaxhmentit**

Sa i përket pikës së parë, ne ndajmë mendimin se është një keqkuptim. Faturat për qiranë e zyrës sonë përfshijnë TVSH-në. 16% e vlerës totale është e llogaritur në TVSH. Kjo është kryer në marrëveshje me Administratën Tatimore dhe nga fundi i vitit do të bëhet kompensimi për këtë.

Në momentin që është nënshkruar kontrata, pronari ka prezantuar një Deklaratë për pagimin e TVSH-së dhe sipas kontratës pronari është i obliguar të paguaj të gjitha tatimet përfshirë këtu edhe TVSH-në.

---

Kur bëhet fjalë për dy çështjet tjera, zyra jonë duhet të kryej veprimtaritë e veta administrative në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2005/11, që i ofron menaxhmentit instruksione mbi menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë qeveritare si dhe detajet në lidhje me heqjen e pasurisë nga përdorimi, matjen, koston dhe zhvlerësimin ose shlyerjen e pasurisë

Është ambicie e jona që të përmbushim këto kërkesa dhe të marrim parasysh rekomandimet e Auditorëve të jashtëm për të zhvilluar procedurat tona gjatë këtij viti.

### **Pasqyrat Financiare**

(Shih Aneksin)